

veprimet e veta. Kjo është për njeriun arë e ahiretit. Sot mbjell në këtë botë, nesër korr në botën tjetër.

Vëllezër të nderuar! Kjo botë në peshojën e Allahut nuk peshon as sa krahu i mushkonjës. Vetëm në dunja i bëhet mëkat Allahut, vetëm në te kundërshtohen urdhërat e Tij, prandaj edhe është e mjerë. Armiqtë e Allahut në këtë botë argëtohen dhe sillen me arrogancë, ndërsa dashamirët e Tij shtypen dhe torturohen. Të mjerët ne, në qoftë se na tërheq kjo botë dhe e harrojmë botën tjetër (ahiretin). Allahu dunjanë ia jep atij që do, por edhe atij që nuk e do, kurse fenë dhe ahiretin ia jep vetëm atij që e do. Dine se nuk ka vlerë feja pa dituri, por edhe nuk ka vlerë edhe dituria pa vepër. Po ashtu edhe vepra nuk ka vlerë pa sinqetit në të. E lusim Allahun e madhërishtëm që të na ndihmojë me kujdesin dhe suksesin e Tij, ashtu që të jemi prej atyre që mësojnë për të vepruar, që veprojnë për ta treguar sinqeritetin dhe janë të sinqertë për ta fituar kënaqësinë e Allahut dhe Xhennetin e Tij.

Përshtati: Sehad Kadiri

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com



3. Bërja e rukusë, ngritja nga ajo, pastaj sexhdeja dhe të qëndëruarit ulur ndërmjet dy sexhdeve janë të domosdoshme në namaz, pra nuk lejohet të shkojmë menjëherë pas rukusë në sexhde pa qëndëruar një kohë në këmbë, e kështu me radhë.

4. Të gjithë veprat që i bëjmë në namaz ato duhet të kryhen me qetësi (pa nxituar) dhe me përkushtim.

5. Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) nuk ia tregoi formën e saktë të namazit këtij personi, derisa ai e përsëriti namazin tri herë, për shkak që ta kuptojë gabimin që e bënte vetë dhe pastaj ta pranojë këshillën me bindje.

Përgatiti: Alaudin Abazi

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
e-mail: penastudentore@hotmail.com



Keqbërësi i NAMAZIT të tij



Falënderimi i takon vetëm Allahut [subhanehu ue teal], Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kë e udhëzon Allahu në rrugë të drejtë nuk ka kush e largon nga ajo (rruga e drejtë) dhe kë e le në humbje Ai, nuk ka kush e udhëzon në rrugë të drejtë. Paqja, mëshira dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi krijesën më të zgjedhur të Tij, Muhammedin [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem], mbi familjen e tij të ndershme, mbi shokët-as'habët e tij besnikë dhe mbi të gjithë pasuesit e Rrugës së Drejtë. Dëshmoj se nuk meriton të adhurohet askush tjetër pos Allahut dhe dëshmoj se Muhammedi [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem] është rob dhe i dërguar i Allahut.

Duke parë sjelljen e një pjese të kosiderueshme të nxënësve të dijes (Talibul-ilm) të cilët mirren me nxënien e diturisë për përfitimin e të mirave materiale në këtë botë dhe duke mos i kushtuar kujdes kënaqësisë së Allahut të Madhëruar, i zgjedha këto fjalë që do të mund t'i lexoni në vazhdim të këtij shkrimi ashtu që duke shpresuar në ndihmën e Allahut të përfitoj unë dhe ju të cilët e lexoni. E lusim Allahun e Madhëruar që këtë vepër të na pranoj si pjesë e veprave tona të mira dhe gjithashtu e lusim Allahun e Madhëruar që edhe lexuesve të këtij shkrimi t'u bëj dobi leximi i tij.

Transmetohet nga Muadh ibn Xhebeli se Pejgamberi [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem] ka thënë:

“Biri i Ademit nuk mund të hapërojë Ditën e Kijametit para se t'ju përgjigjet 4 (katër) pyetjeve:

- *Jetën e vet ku e kaloi;*

- *Rininë e vet ku e çoi;*

- *Pasurinë e vet si e fitoi dhe ku e harxhoi, dhe*

- *Diturinë e vet ku e praktikoi”.*

Vëllezër të nderuar! Ky hadith është barrë e rëndë për bartësit e diturisë, sepse nesër Allahu i Madhëruar pa dyshim do t'i pyesë sa e praktikuan diturinë e vet dhe ç'vëpruan me të. Ashtu do të pyetet edhe çdo i moshërritur për dhuntitë e Allahut që ia dhuroi, ç'veproi me to. Dhuntitë e jetës, të rinisë, të pasurisë dhe në fund të diturisë. Me diturinë Allahu [subhanehu ue te'ala] e dalloj njeriun nga shtazët. Dituria është dhunti shumë e çmueshme, prandaj Allahu ia fal vetëm atij që e do. Ndërsa falënderimi ndaj këtij ni'meti (dhuntie) është të vepros sipas saj dhe t'ua

mësosh të tjerëve. Kush merr dituri dhe vepron sipas saj, vetëm ai ka marr dituri dhe meriton të quhet Dijetar dhe Edukator. E kush mëson diçka e pastaj e fsheh nga njerëzit, kurse ata kanë nevojë për diturinë e tij, do të goditet në Ditën e Kijametit me gaca të zjarrit. Ndërsa ai që mëson dhe nuk vepron sipas asaj që e ka përvetësuar, i përngjanë gomarit të ngarkuar me libra të çmuar. Gjëja që më së shumti e frikësonte Muhammedin [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem] për ummetin pas vdekjes së tij ishte munafiku i dijshtëm.

Munafiku i dijshtëm! Parashtrohet pyetja si është e mundur që njeriu të jetë njëkohësisht dijetar dhe munafik?!

Munafik i dijshtëm është ai dijetar që gjuhën e ka të mprehtë kurse zemrën e zbrazët nga frika ndaj Allahut [subhanehu ue te'ala]. Nga Aliu, radjallahu anhu, transmetohet se Pejgamberi [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem] ka thënë:

“*Vërtet, unë nuk brengosem për ju nga ndonjë besimtarë apo mushrik. Besimtarin e mbron imani i tij, kurse mushrikun e asgjëson kufri i tij. Por brengosem për ju nga ndonjë munafik që diturinë e ka vetëm në gjuhë. Flet për atë që ju e doni, kurse punon për atë që ju e urreni”.*

Vëllezër të nderuar, ky pra është ai që kokën e ka përplot dituri, kurse zemrën e ka të zbrazët nga frika ndaj Allahut [subhanehu ue te'ala].

Shtrohet pyetja se:

Cila është shenja e frikës ndaj Allahut [subhanehu ue te'ala]?

Shenja e frikës ndaj Allahut [subhanehu ue te'ala] është të vëndosh kufi mes vetes dhe mëkateve.

Por, çka e ndihmon njeriun t'ia ketë frikë Allahut [subhanehu ue te'ala]?

Në këtë aspekt njeriun e ndihmon përkujtimi i vdekjes dhe ahiretit. Kjo i pastron zemrat e damkosura dhe ia zvogëlon njeriut lakminë ndaj kësaj bote. Pejgamberi [sal-IAllahu 'alejhi ue sel-lem] na ka lënë dy këshilltarë. Njëri flet e tjetri hesht. Ai që flet është **Kur'ani**, ndërsa ai që hesht është **vdekja**. Këta dy këshilltarë mjaftojnë për besimtarin. Zemra e besimtarit fillon të varfërohet pikërisht kur e kaplon harresa e vdekjes.

A nuk kuptohet nga kjo se besimtari e nënçmon jetën dhe e urren atë?

Jo, vëlla i dashur! Çdo ditë për besimtarin është me vlerë. Gjatë jetës ai e adhuron Allahun, është i dobishëm për krijesat e tij dhe i kontrollon

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në një rast hyri në xhami, pas një kohe hyn një person, fal namazin e pastaj vjen te Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe i jep selam. Ai ia kthen selamin e i thotë: “*Kthehu e falu, se ti nuk je falur.*” Ai shkoi e u fal pastaj erdhi te Pejgamberi dhe i dha selam, ai prap i tha: “*Kthehu e falu se ti nuk je falur.*” (kështu veproi tri herë) Herën e tretë personi i tha të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!): “Pasha Atë që ty të dërgoi me të vërtetën unë nuk di të falem më mirë, prandaj më mëso!”

I Dërguari i Allahut i thotë:

“*Kur të ngritesh për të falur namazin, atëherë thuaje tekbinin fillestar (Allahu ekber), këndo diçka nga Kur'ani (ndonjë pjesë që di), pastaj bëje rukunë dhe rri derisa të qetësohesh, pastaj shko në sexhde dhe rri derisa të qetësohesh, pastaj ngritu nga sexhdeja dhe rri ulur derisa të qetësohesh, pastaj shko në sexhde dhe rri derisa të qetësohesh e kështu vepro gjatë tërë namazit tënd.*” (Transmeton Buhariu dhe Muslimi).

Komenti i hadithit

Namazi është shtylla e Islamit dhe gjëja më e rëndësishme pas dëshmisë (shehadetit).

Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) sqaroi formën e namazit në thënie e vepra dhe muslimanin nuk i lejohet ta falë atë vetëm se ashtu siç e ka falë Pejgamberi (salallahu alejhi ue selem).

Ky hadith, te dijetarët e fikhut, njihet si hadithi i keqbërsit të namazit të tij.

Ndërkohë që Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ishte ulur në xhaminë e tij në Medinë hyri një person dhe fali namazin, mirëpo mënyra se si e fali ai nuk ishte në rregull, nuk e bënte rukunë, ngritjen nga ajo, sexhden dhe veprat tjera në namaz ashtu siç duhet. I Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) e shikonte atë dhe pasi përfundoi namazin erdhi te Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) dhe e përshëndeti me selam, ai ia ktheu selamin dhe e urdhëroi ta përsëriste namazin, kështu veproi tri herë e herën e tretë, pasiqë u bind se namazin nuk po e falte në rregull, kërkoi nga Resulullahu (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) t'ia mësojë mënyrën e saktë të tij.

Nga ky hadith dijetarët nxjerrin shumicën e dispozitave, farzeve dhe vaxhibeve, që duhet bërë në namaz, qofshin ato thënie apo vepra, kurse dispozitat e tjera i nxjerrin nga disa hadithe të tjera.

Ky hadith në vete përmban shumë dobi e ne do t'i përmendim disa:

1. Obligueshmëria e tekbinin fillestar të bëhet me thënien “Allahu ekber” dhe nuk lejohet të fillohet namazi me ndonjë thënie tjetër në vend të saj.

2. Domosdoshmëria e leximit të Kur'anit në namaz, kurse në hadithe të tjera vërtetohet leximi i Fatihas.